



Si të aplikoni?

Mundësitet e financimit për 2021-2027 dhe informacioni se si të aplikoni janë publikuar në portalin e Komisionit Evropian për Financimin dhe Mundësitet e Tenderit:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/home>



Ngritja e kapaciteteve  
në fushën e  
**ARSIMIT TË LARTË**

**ERASMUS+**

[ec.europa.eu/erasmus-plus](http://ec.europa.eu/erasmus-plus)  
[eacea.ec.europa.eu](http://eacea.ec.europa.eu)  
[facebook.com/EUErasmusPlusProgramme](https://facebook.com/EUErasmusPlusProgramme)  
[EU\\_Erasmus\\_Plus](https://twitter.com/EU_Erasmus_Plus)

**Zyra e Erasmus+ në Kosovë**

[office@erasmuspluskosovo.org](mailto:office@erasmuspluskosovo.org)  
[www.erasmuspluskosovo.org](http://www.erasmuspluskosovo.org)  
[facebook.com/erasmuspluskosovo](https://facebook.com/erasmuspluskosovo)  
<https://www.linkedin.com/company/kosovo-erasmus-office/>



Mbështetur nga:  EUROPE  
HOUSE



Ngritja e kapaciteteve  
në fushën e  
**ARSIMIT TË LARTË**

## Çfarë është projekti CBHE?

Projekti i Ngritjes së Kapaciteteve për Arsimin e Lartë funksionon si partneritet shumëpalësh ndërmjet institucioneve aktive në fushën e arsimit të lartë nga vendet e programit dhe vendet partnere.

Projektet mbështesin rëndësinë, cilësinë, modernizimin dhe aksesin e arsimit të lartë, për ta bërë atë një shtysë për zhvillim të qëndrueshëm, social dhe ekonomik. Të gjitha projektet duhet të ndjekin dhe respektojnë parimet udhëzuese të veprimit: gjithëpërfshirje, inovacion, impakt dhe qëndrueshmëri.

## Tri lloje projekteve:

### 1. NXITJA E QASJES NË BASHKËPUNIM NË ARSIM TË LARTË:

Këto projekte më të vogla janë të fokusuara në institucionet e arsimit të lartë. Ky lloj projekti është i ri dhe i projektuar për t'u kujdesur për të sapoardhurit në program, për vendet/rajonet më pak të përfshira dhe për grupet e synuara në disavantazh. Buxheti i projektit është nga 200 000 dhe 400 000 euro, për 2-3 vjet.

### 2. PARTNERITET PËR TRANSFORMIM NË ARSIM TË LARTË:

Këto janë gjithashtu të fokusuara në institucionet e arsimit të lartë, por të dizajnuara për të pasur një ndikim më të madh dhe më të gjerë në inovacionin, marrëdhëniet universitet/biznes dhe qeverisjen institucionale. Buxheti i projektit është 400 000 dhe 800 000 euro, për 2-3 vjet.



### 3. PROJEKTET E REFORMËS STRUKTURORE:

Këto projekte fokusohen në nivelin makro të reformave të politikave të nevojshme për të nxitur ndërkombëtarizimin. Përveç institucioneve të arsimit të lartë, ato do të kërkojnë gjithashtu përfshirjen e autoriteteve arsimore dhe/ose ministrike. Buxheti i projektit ndërmjet 800 000 euro dhe 1 000 000 euro, për 3-4 vjet.

### Kush mund të aplikojë dhe të marrë pjesë në Ngritjen e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë? Si?

#### Pjesëmarrja si organizatë:

Pjesëmarrja në projektet CBHE është e hapur për një sërë palësh të interesuara në sektorin e arsimit të lartë:

#### Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)

- Institucionet e arsimit të lartë, shoqata ose organizata të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe organizata rektoresh, mësuesish ose studentësh të njohur ligjërisht, kombëtarë ose ndërkombëtarë;
- Organet përgjegjëse për arsimin e lartë (këshillat, agjencitë) dhe autoritetet kombëtare (ministratë, departamentet e arsimit të lartë) në vendet partnere për projekte që mbështesin proceset e reformës në nivel kombëtar/rajonal;
- Vektorët e ndryshimit në sistemin arsimor (menaxherët e universiteteve, departamentet ndërkombëtare, dekanët, agjencitë e cilësisë, etj.);
- Organizatat dhe/ose shoqatat aktive në tregun e punës ose në fushën e arsimit, trajnimit ose rinisë në vendet partnere.